

Irir Binaj, Drejtor i Përgjithshëm i DPT-së

Irir Binaj është lindur në Durrës në 23 Shkurt 1976. Prej muajit Tetor 2024, z.Binaj mban detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve

Përpara kësaj detyre Z. Binaj ka pasur një eksperiencë të gjatë në fushën e auditimit dhe taksave ku për më shumë se 15 vite ka mbajtur pozicione si Drejtues në kompani të ndryshme ndërkombëtare.

Z.Binaj është i Çertifikuar si Auditues Publik në Kaliforni (CPA), si Kontabilist i Çertifikuar Global i Menaxhimit (CGMA) në Mbretërinë e Bashkuar, dhe si Auditues Ligjor në Shqipëri.

Studimet e larta z. Binaj i kreu në Universitetin e Tiranës, Fakultetin Ekonomisë, në degën Financë në vitin 2002, ndërsa studimet Master i kreu në “Business Administration” në Universitetin e Dallas Baptist, SHBA në vitin 2009. Gjithashtu Z.Binaj zotëron një Diplomë Master Profesional për Kontabilitet dhe Taksa nga Universiteti i Teksasit.

Z.Binaj është anëtar i Institutit Amerikan të Kontabilistit Publik të Certifikuar (AICPA) i Certifikuar për shërbime të zbulimit të mashtrimit financiar dhe vlerësimit të bizneseve.